



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10.5.2023

Nr: 479

Ora: 13:30

VENDIM

PËR

**VLERËSIMIN E RAPORTIT TË AUTORITETIT TË MEDIAS AUDIOVIZIVE TË PASQYRIMIT TË  
FUSHATËS ZGJEDHORE NGA OSHMA-TË PËR PERIUDHËN 1-5 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neneve 78, 80, 81, 83, 84, 85 dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 2, datë 30.1.2021, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VËREN:

Pika 6 e nenit 85 të Kodit Zgjedhor përcakton se, radiot dhe televizionet publike dhe private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Këto regjistrime ruhen deri në mbarimin e dhjetë muajve nga data e zgjedhjeve dhe vihen, me kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, menjëherë në dispozicion të saj.

Neni 8 i vendimit nr. 2, datë 30.1.2021, i Komisionit Rregullator, “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive” parashikon se, OSHMA-t vendore që nuk mbulohen nga mjetet monitoruese janë të detyruara të depozitojnë pranë AMA-s, përmbajtjen e transmetuar në fillim të çdo dite pasardhëse monitoruese.

Referuar vendimit nr. 37, datë 8.5.2023 të AMA-s “Për shqyrtimin e raportit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 1-5 Maj 2023”, konstatohet si vijon:

I. Depozitimi i regjistrimeve në AMA

1. Subjektet audiovizive të cilët nuk kanë paraqitur regjistrimet pranë AMA-s nga data 1 deri në datë 5 Maj 2023 janë OSHMA-të:

- Gold TV

- Channel 7

Data: 10.5.2023 Nr: 479  
Ora: 13:30



“Për vlerësimin e raportit të Autoritetit të Medias Audiovizive të pasqyrimin të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 1-5 maj 2023”

- TV 1 Channel
- Tv Klaudian
- Saranda TV

AMA i propozon KQZ-së që për këto 5 (pesë) OSHMA të procedohet me marrje mase administrative sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

## II. Të dhëna mbi edicionet informative

Pika 2 e nenit 80, të Kodit Zgjedhor parashikon se, radiotelevizioni publik e pasqyron fushatën zgjedhore nëpërmjet lajmeve dhe programeve informative, në përputhje me parimet e paanshmërisë, plotësisë, vërtetësisë dhe pluralizmit të informacionit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon fushën e mediave elektronike.

AMA i propozon KQZ-së që të procedohet me masë administrative për radiotelevizionin publik (RTSH) për mosrespektim të raporteve kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, sipas mbulimit konkret që i kanë bërë fushatës zgjedhore në periudhën 14 prill – 5 maj 2023, sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

Në datën 09 Maj, z. Zaganjori ka sjellë një email në të cilin sqaron konstatimet e AMA-s. Sipas RTSH, *nuk ka dispozitë ligjore që të sugjerojë marrjen e masave administrative ndaj një OSHMA-je në mes të fushatës zgjedhore kur nuk ka kryer një shkelje flagrante të ligjit. Kodi Zgjedhor dhe udhëzimi i KQZ për ndarjen e kohës televizive për subjektet politike në media nuk parashikon që të merren masa nëse OSHMA-të nuk balançojnë kohën për një ditë, për një javë, apo për 20 ditë, por nëse do të ndodhte, kjo do të ishte vetëm në përfundim të fushatës zgjedhore.*

*Për shkak të angazhimeve në fushatë, kandidati i Partisë Demokratike për Tiranën nuk i është përgjigjur kërkesave për të qenë pjesë e një segmenti në emisionin "Një ditë në Fushatë" që transmetohet të dielave në RTSH 1 në orën 23:00. Kandidati i Partisë Demokratike, Roland Bejko ka qenë ditën e martë, në datë 9 maj në emisionin "Publikisht" në RTSH 1 në orën 21:00. Koha e kandidatit Roland Bejko ditën e martë, datë 9 Maj 2023, dhe ritransmetimi i emisionit në datë 10 maj 2023, po në RTSH 1, në orën 13:30, balancon kohën e dy kandidatëve të tjerë, atij të koalicionit Bashkë Fitojmë dhe atij të Partisë Socialiste në dy javët paraardhëse. Monitorimi i AMA-s duke qenë i pjesshëm, jo për të gjithë kohën e fushatës, por vetëm për 20 ditë, ka nxjerrë të pabalancuar kohën televizive të tre kandidatëve, por AMA nuk mundet të dalë në përfundime përfundimtare, kur fushata është ende në vazhdim, dhe kur mjaftojnë vetëm dy ditë që të rrezojnë pretendimet e Bordit të AMA-s dhe për pasojë edhe propozimet për masë administrative. Për arsye të angazhimeve të fushatës, kandidati i Partisë Demokratike, Roland Bejko ka zgjedhur të jetë edhe në emisionet e tjera në RTSH 1 në javën e fundit të fushatës së tij, emisione që janë të programuara si nga ne si nga zoti Bejko dhe që mjaftojnë për të balancuar kohën televizive, që sipas AMA-s mungon.*

*Për emisionet "Një Ditë në Fushatë dhe Kandidati", RTSH ka hasur probleme me kandidatët në zgjedhje, të cilët shpesh herë nuk i përgjigjen ftesave për të qenë të pranishëm në emisionet*

*tona zgjedhore përfshirë edhe kandidatët e Partisë Demokratike. Kjo ka bërë që të detyrohem të gjejmë forma të tjera për të kompensuar kohën e tyre televizive, pa cënuar programacionin tonë me transmetimin e emisioneve edhe pa praninë e tyre siç do të dëshironim të ishte. Por kjo kërkon kohën e nevojshme, dhe nuk mjaftojnë vetëm dy javë fushatë për të arritur balancën perfekte siç kërkon AMA vetëm nga RTSH.*

*Në lidhje me disbalancën që AMA pretendon në edicionet informative në RTSH 1, edhe pse shumë e kufizuar, kjo varet më së shumti nga vonesa e fillimit të aktiviteteve të Partisë Demokratike, të cilat kanë qenë shumë të pakta ditët e para të fushatës, edhe nga numri i kufizuar i tyre për shkak të mungesës edhe të kandidatëve ndoshta, në të gjithë Shqipërinë. Pavarësisht kësaj jemi munduar të balancojmë sa më shumë kohën televizive në edicionet informative dhe synojmë të arrijmë një balancë sa më të pranueshme të të gjithë subjekteve zgjedhore deri në fund të fushatës.*

Pika 1 e nenit 81, të Kodi Zgjedhor parashikon se, në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. I njëjti parashikim zbatohet edhe për OSHMA-të private.

AMA i propozon KQZ-së që OSHMA-të private sipas mbulimit konkret që i kanë bërë fushatës në periudhën 14 prill – 5 maj 2023, të bëjnë në vijim kompensimin në kohë transmetimi, në edicionet informative për efekt balancimi.

### III. Të dhëna mbi reklamën politike

Referuar pikave 4, 5 dhe 7, të nenit 84, të Kodit Zgjedhor, parashikohen kriteret ligjore për transmetimin e reklamës politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

*Pika 4, e nenit 84, të Kodit Zgjedhor parashikon se “Vetëm subjektet zgjedhore të regjistruara për zgjedhje kanë të drejtë të transmetojnë reklama politike gjatë periudhës zgjedhore në radiot, televizionet apo mediat audiovizive private, qofshin këto numerike, kabllore, analoge, satelitore apo të çdo lloj forme dhe mënyre të transmetimit të sinjalit. Reklamën politike të koalicioneve zgjedhore llogariten brenda kohës së partive politike anëtare të koalicionit, sipas marrëveshjes individuale të secilës parti me operatorin radioteleviziv. Reklama politike duhet të identifikojë qartë subjektin porositës. Në rast se reklama politike nuk është identifikuar qartë, KQZ-ja urdhëron pezullimin e menjëhershëm të transmetimit të saj derisa të bëhet identifikimi i kërkuar nga kjo pikë.”*

Pika 5 e nenit 84, të Kodit Zgjedhor parashikon se “Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje...”

Pika 7 e nenit 84, të Kodit Zgjedhor parashikon se *“Reklamat politike të subjekteve zgjedhore transmetohen ndërmjet intervaleve kohore nga ora 15:00 deri 18:00 dhe nga ora 21:00 deri 24:00 të programit ditor.”*

1. OSHMA-ja Shijak TV dhe Syri TV e kanë tejkaluar kohën prej 90 minutash për njërin prej subjekteve zgjedhore konkurruese. Konkretisht, koha për OSHMA-në Shijak TV është tejkaluar me 298,32 minuta (nga tabela nr. 3 bashkëlidhur vendimit të AMA-s rezulton 388,32 minuta), ndërkohë që për OSHMA-në Syri TV është tejkaluar me 18.97 minuta (nga tabela nr. 3 bashkëlidhur vendimit të AMA-s rezulton 109 minuta).

AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që t’i kërkojë 2 (dy) OSHMA-ve ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike përtej minutazhit të përcaktuar e të lejuar në Kodin Zgjedhor.

Për OSHMA-në Shijak TV, në shqyrtimin e raportit të dytë të AMA-s, për periudhën 23-30 Prill 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 451, datë 6.5.2023 vendosi ndërprerjen e transmetimit të reklamave për subjektin zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ndërkohë rezulton që kjo OSHMA vazhdon edhe transmeton akoma reklama politike të këtij subjekti zgjedhor.

2. OSHMA-të të cilat kanë transmetuar reklama politike jashtë kohës së përcaktuar nga Kodi Zgjedhor janë:

- Shijak TV ka transmetuar reklama jashtë fashës orare të lejuar për datat:

1 maj (08:21; 08:42; 08:45; 08:50; 11:58; 14:35; 18:30; 19:58; 20:27; 20:32; 20:37 dhe 20:43)

2 maj (08:47; 08:48; 08:51; 08:52; 08:54; 08:58; 08:59; 11:06; 11:16; 11:48; 13:13; 13:47; 18:36; 19:39; 19:43; 19:45; 19:49; 19:58; 20:33 dhe 20:37)

3 maj (08:10; 08:13; 08:14; 08:28; 11:52; 14:36; 18:33; 18:33; 18:39; 18:43; 18:48; 19:40; 19:44 dhe 20:35)

4 maj (08:30 08:31 08:32; 08:37; 09:00; 09:03; 09:58; 12:39 dhe 14:23)

5 maj (08:00; 08:28; 08:43; 08:45; 08:48; 09:11; 09:44; 12:30; 13:33; 13:54; 14:27)

- Fax News ka transmetuar reklama jashtë fashës orare të lejuar për datat:

2 maj (11:59)

4 maj (14:25)

- Syri TV ka transmetuar reklama jashtë fashës orare të lejuar për datat:

2 maj (19.59)

- Klan Plus ka transmetuar reklama jashtë fashës orare të lejuar për datat:

3 maj (12:15)

- Vizion Plus ka transmetuar reklama jashtë fashës orare të lejuar për datat:

3 maj (18.12)

4 maj (18;20 dhe 20;58)

5 maj (14;45 18:22 dhe 20;54)

- TV Bulqiza ka transmetuar reklama jashtë fashës orare të lejuar për datat:

5 maj (08:36; 09:03; 09:24; 10:11; 11:03; 11:09; 14:57; 18:34; 18:56; 14:03; 14:32; 20:24)

AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t'i kërkojë këtyre 6 (gjashtë) OSHMA-ve që të ndërpresin transmetimin e reklamave politike në kohën e ndaluar.

AMA ka identifikuar që OSHMA-ja Syri Tv ka transmetuar reklamë politike në edicionin e lajmeve, konkretisht për datat:

2 maj (23:39)

3 maj (12:29; 13:30; 14:35; 16:22; 22:59 dhe 23:27)

4 maj (12:47; 12:49; 13:20; 16:17; 16:35 dhe 19.23)

AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t'i kërkojë OSHMA-ve që të ndërpresë transmetimin e reklamave politike brenda edicionit të lajmeve.

#### IV. Raporti i përfaqësimit gjinor në fushatë

AMA i propozon KQZ-së t'i tërheqë vëmendjen OSHMA-ve për të rritur nivelin e ndjeshmërisë ndaj kriterit të përfaqësimit gjinor në fushatën zgjedhore.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, nenet 78, 80, 81, 83, 84, 85 dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimin nr.2, datë 30.1.2021, të Komisionit Rregullator "Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive", të ndryshuar,

#### **V E N D O S:**

1. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv:
  - Gold TV
  - Channel 7

- TV 1 Channel
  - Tv Klaudian
  - Saranda TV
2. Të gjitha OSHMA-të të bëjnë menjëherë kompensim në kohë transmetimi, në edicionet informative për efekt balancimi.
  3. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë për OSHMA-në Shijak TV.
  4. Ndërprerjen e transmetimit menjëherë të reklamave politike për OSHMA-të Shijak Tv dhe Syri TV për subjektin zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
  5. Ndërprerjen e transmetimit menjëherë të reklamave politike jashtë intervaleve kohore të përcaktuara, për OSHMA-të si më poshtë vijon:
    - Shijak TV
    - Fax News
    - Syri Tv
    - Klan Plus
    - Vizion Plus
    - TV Bulqiza
  6. T’u tërheqë vëmendjen të gjitha OSHMA-ve për respektimin e kriterit të përfaqësimit gjinor në fushatën zgjedhore.
  7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
  8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**